

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE DHJETOR 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesë	Tarifa
58	03.12.2025	Pershendetje! Jam student ne vitin e trete, dega Agroushqim. Doja te pyesja ne lidhje me vijimin e mbeshtetjes financiare per kete vit. Dorezimi i dokumentacionit eshte bere njelloj si edo vit por akoma nuk kemi nje pergjigje zyrtare nderkohe qe vitin e kaluar ky proces kishte perfunduar qe ne nentor dhe ne dhjetor kishin kaluar edhe pagesat. Ky nuk esht nje shqetesim vetem i imi por i te gjithë perfituesve te grupit tim. Ne pritje te pergjigjes suaj, Faleminderit!	04.12.2025	Përsëndetje, Faleminderit që na kontaktuat. Ju informojmë se procesi i vijueshmërisë për Mbështetjen Financiare po zhvillohet sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 04.11.2022, i ndryshuar, të Ministrisë së Arsimit. Duke qenë se viti akademik ka filluar zyrtarisht më 7 tetor, afatet e dorëzimit të dokumentacionit dhe të verifikimit nga universitetet janë ndjekur sipas këtij kalendari. Gjatë muajit tetor, studentët dorëzojnë dokumentet për vijueshmërinë, ndërsa gjatë muajit nëntor AKFAL merr konfirmimet zyrtare nga institucionet përkatëse për notën mesatare dhe përmbushjen e detyrimeve akademike. Pas përfundimit të këtyre verifikimeve, lista përfundimtare e studentëve përfitues miratohet nga Bordi Drejtues i AKFAL brenda muajit dhjetor, dhe më pas studentët njoftohen individualisht. Ju sigurojmë se çdo student që ka plotësuar kriteret do të njoftohet zyrtarisht sapo të mbyllet procedura. Faleminderit për mirëkuptimin. Me respekt,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
59	04.12.2025	I nderuar staf i AKFAL Shpresoj të jeni mirë. Unë jam studente në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, programi Bachelor, viti i tretë. Po përpiqem të aplikoj për mbështetjen financiare për degët prioritare për vitin akademik 2025–2026, por po has një problem me shërbimin online. Në portalin e-Albania, në shërbimin që më shfaqet nën emërtimin AKFAL – Mbështetje financiare, sistemi më shfaq këtë mesazh: “Ju nuk mund të aplikoni për Mbështetje financiare. Aplikimet për këtë shërbim lejohen vetëm për studentët e vitit të parë.” Këtë mesazh e bashkëngjitur po e dërgoj edhe në foto.Nga sa kuptoj, ky shërbim është vetëm për studentët e vitit të parë dhe jo për studentët e viteve të dyta apo të treta, ndërkohë që bursat për degët prioritare për këto vite duhet të kenë një formular tjetër.Në institucionin tim (fakultet / rektorat) nuk kam marrë një përgjigje të qartë, dhe më kanë këshilluar të kontaktoj me ju. Prandaj, ju lutem të më sqaroni: A është hapur zyrtarisht formulari i aplikimit për mbështetjen financiare për degët prioritare për studentët e vitit të tretë për vitin 2025–2026? Nëse po, cili është linku ose procedura e saktë për të aplikuar? Nëse jo, kur pritet të aktivizohet shërbimi? A ekziston mundësia të dorëzoj aplikimin fizikisht ose me email ose postë, nëse shërbimi online nuk është aktiv? Ju falënderoj për kohën dhe bashkëpunimin. Pres përgjigjen tuaj sa më shpejt, pasi afatet e aplikimit po afrojnë.	05.12.2025	Përsëndetje, Në përgjigje të emailit tuaj, ju bëjmë me dije se shërbimi elektronik në portalin e-Albania për aplikimin në mbështetjen financiare është i hapur vetëm për studentët e vitit të parë. Për këtë arsye, sistemi ka refuzuar aplikimin tuaj. Si studente e vitit të tretë, ju konsideroheni vijues për vitin akademik 2025–2026 dhe nuk aplikoni nëpërmjet portalit e-Albania. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër na ka përcjellë informacionin mbi shlyerjen e detyrimeve tuaja akademike për vitin 2024–2025, dhe mbi këtë bazë do të vijojmë me procedurat për vitin akademik 2025-2026. Referuar pikës 11 të Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022, përcaktohet se: “Për vitet akademike pasardhëse, pas vitit akademik të nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, lista me të gjithë përfituesit e çdo viti akademik miratohet brenda muajit dhjetor, duke i njoftuar studentët përfitues dhe institucionet publike të arsimit të lartë.” Për çdo hap të mëtejshëm në lidhje me vijueshmërinë do të njoftoheni me email. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
60	09.12.2025	Mirembrema, kemi derguar dokumentat ne rruge postare ne lidhje me perfitimim e burses ne Master Matematike. A mund te na informoni ne lidhje me vijimesine e burses dhe a jane dokumentet ne rregull? A kemi perjashtim nga tarifa pasi jam edhe nxenese ekselence edhe ne dege prioritare? Ju lutem merreni parasysh kete email. Faleminderit	16.12.2025	Përsëndetje, Për vijimësinë e përfitimit të mbështetjes financiare ju do të njoftoheni me email. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
61	13.12.2025	Të nderuar drejtues! Jam prind i studentes së mjekësisë. Është cilësuar ekselente nga vlerësimet e maturës shtetërore dhe në provimin hyrës të fakultetit të mjekësisë e renditur e para .Aplikon për bursë në ealbania por aty thuhet që fakulteti nuk përditëson të dhënat.Afati është deri në 20 dhjetor. Ju lutemi shumë , ndiqeni juve ku është ngërci në këtë procedurë. Është për të ardhur keq që të zhgënjehen studentët ekselentë nga burokracirat e institucioneve. Me respekt prindi:	15.12.2025	E nderuar, Së pari, ju urojmë dhe ju përgëzojmë për rezultatet shumë të mira të arritura nga vajza juaj në Maturën Shtetërore dhe në provimin hyrës në Fakultetin e Mjekësisë, të cilat përbëjnë arritje të vlerësueshme. Në lidhje me shqetësimin tuaj mbi aplikimin për mbështetje financiare, ju informojmë se problematika e konstatuar në sistem lidhet me faktin se një pjesë e studentëve të vitit të parë nuk janë pajisur ende me numër matrikullimi, element i domosdoshëm për përditësimin e të dhënave. Kjo procedurë realizohet nga RASH dhe QSHA dhe nuk është në kompetencë të AKFAL. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë situatë, AKFAL ka marrë masat e nevojshme, duke sqaruar se, në kushtet kur aplikimi për mbështetjen financiare nuk mund të kryhet përmes portalit e-Albania, studentët duhet të paraqitet për të kryer aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, sipas procedurës së parashikuar. Ky sqarim është publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit, www.akfal.gov.al, më datë 27.10.2025. Në këtë kuadër, ju sqarojmë se situata nuk lidhet me burokraci institucionale, por me një proces administrativ që kërkon bashkërendim ndërinstitucional dhe zhvillohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ju ftojme të paraqiteni pranë zyrave të AKFAL,Adresa: Rruga “Naim Frashëri”, nr. 37, Tiranë me dokumentacionin përkatës, për të vijuar me aplikimin. Me respekt,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo

62	16.12.2025	Mirembrema, kemi derguar dokumentat ne rruge postare ne lidhje me perfitimin e burses ne Master Matematike. A mund te na informoni ne lidhje me vijimesine e burses dhe a jane dokumentet ne rregull? A kemi perjashtim nga tarifa pasi jam edhe nxense ekselence edhe ne dege prioritare? Ju lutem merreni parasysh kete email. Faleminderit	16.12.2025	Përsëhëndetje, Për vijimësinë e përfitimit të mbështetjes financiare ju do të njoftoheni me email. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
63	17.12.2025	Pershendetje! Mund te me jepni me shume info rreth aplikimit per burse per studentet e shkelqyer. A mund te behet aplikimi nga e albania, pasi universiteti nuk ka shume informacion rreth kesaj burse	17.12.2025	Përsëhëndetje, Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet fizikisht pranë AKFAL-it si pasojë e mosfunksionimit të përkohshëm të shërbimit në platformën qeveritare e-albania. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
64	18.12.2025	Kam marrë këtë email për të dorëzuar këtë dokument. A është i nevojshëm në rastin e bursës prioritare ky dokument? "Përsëhëndetje, Në përmblylje të procesit të vijueshmërisë së mbështetjes financiare për vitin akademik 2025-2026, ju lutem të përcillni pranë AKFAL dokumentin e mëposhtëm: Vërtetim nga portali qeveritar e-albania që ju nuk jeni të punësuar në një nga institucionet shtetërore. Ju faleminderit"	23.12.2025	Në këtë përgjigje është sqaruar qartë dhe në mënyrë përfundimtare se paraqitja e vërtetimit nga portali e-Albania që nuk është e punësuar në një institucion shtetëror është detyrim ligjor, i domosdoshëm për përmblylljen e procesit të vijueshmërisë së mbështetjes financiare për vitin akademik 2025-2026, përfshirë edhe bursat për programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar. Ju rikujtojmë se: studenti i punësuar në një institucion shtetëror nuk mund të përfitojë njëkohësisht bursë, pasi kjo përbën pagesë të dyfishtë nga fondet publike; për bursat prioritare, punësimi në sektorin publik konsiderohet përmbushje e detyrimit kontraktual për punësim pas përfundimit të studimeve, duke përmbushur kushtin e afatit trevjeçar të parashikuar në marrëveshje, dhe për rrjedhojë ndërpritet vijueshmëria e bursës. Në praktikë, AKFAL ka ndjekur në mënyrë të njëjtë këtë procedurë për të gjithë përfutuesit, përfshirë edhe raste kur studentët përfutues kanë paraqitur në mënyrë vullnetare kontratat e punësimit në institucionet publike, Pavarësisht sqarimeve të dhëna me shkrim dhe brenda afatit normal administrativ të përgjigjes, studentja ka vijuar të dërgojë të njëjtat komunikime të përsëritura, përfshirë edhe jashtë orarit zyrtar të punës dhe në disa adresa njëkohësisht, çka nuk ndryshon procedurën ligjore dhe nuk ndikon në vendimmarrjen administrative. Për rrjedhojë, pa paraqitjen e dokumentit të kërkuar, procesi i vijueshmërisë nuk mund të vijojë dhe nuk mund të përmbillet. Ju informojmë se çdo komunikim i mëtejshëm lidhur me këtë çështje duhet të kryhet vetëm përmes kanaleve zyrtare të AKFAL. Komunikimet e përsëritura për të njëjtën çështje, do mari të njëjtën përgjigje .	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
65	23.12.2025	Jam ____, Kam bërë aplikimin në zyrat e AKFAL-it për bursën e ekselencës. Dua të di nëse përzgjedhja bëhet me kuota? Kur do të dalin përgjigjet dhe kur fillon financimi i studentëve? Ju faleminderit,	23.12.2025	Përsëhëndetje, Tani ne jemi ne proces verifikimi me QSHA, sapo të mbarojë faza e verifikimit përgatiten listat e studenteve që plotësojnë kriteret sipas VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, do të kalojnë për miratim në Bordin Drejtues të AKFAL. Studentet do lajmërohen me email për përzgjedhjen e tyre pas miratimit të listave të fituesve. Hapi i radhës është nënshkrimi marrëveshjes tre palëshe (AKFAL- IAL - Student), pas nënshkrimit të marrëveshjes do të bëhet kalimi i fondit në llogaritë e studenteve. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
66	24.12.2025	Miremengjesi , te me falni po cfare dokumenti tjeter duhet te benim ne lidhje me banken ? Faleminderit !	29.12.2025	Përsëhëndetje, Në zbatim të pikës 9 të VKM nr. 440/2023, "Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor", i ndryshuar, ju informojmë se duhet të vijoni procedurat dhe lidhjen e kontratës së kreditit me bankën e nivelit të dytë. Sa më sipër, lutemi të drejtoheni pranë bankës Intesa Sanpaolo për tu informuar mbi dokumente që duhet të dorëzoni pranë bankës. Faleminderi	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
67	24.12.2025	Ky është email-i që kam marrë nga Help Desk Support i portalit e-Albania për dokumentin që vërteton se nuk jam punësuar në institucione shtetërore. Këto janë dokumentat që mund të përdoren për këtë rast. Nëse është gabim, ju lutem të më ktheni përgjigje: "Pershendetje, Ne portalin e-albania nuk ofrohet dokument qe specifikisht vtereton se nuk jeni punesuar. Ne portal ofrohen sherbimet si 'Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin' dhe 'Vërtetim page' per te vteretuar punesimin aktual. Faleminderit,	24.12.2025	Ju lutem merni vteretim kontributesh ose vteretim page. Faleminderit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
68	29.12.2025	Ju kerkoj shume ndjese per shqetesimin. Jam nje studente e vitit te pare te universitetit qe jam interesuar prane zyrave tuaja dhe kam aplikuar per bursen e ekselences. Doja t'iu pyesja nese kam arritur ta perfitoj apo jo.Ndoshta nuk e kam perfuturuar dhe ju u dergoni email vetem atyre qe e perfitojne por gjithsesi pa ju shqetesuar doja t'iu pyesja. Shume faleminderit dhe gezuar festat!	29.12.2025	Përsëhëndetje, Jemi ende ne proces. Ju do të lajmëroheni me email nëse e përfiton ose jo. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo

69	29.12.2025	Qohem ____ dhe kam qene nje aplikant i burses qe institucioni juaj ofron per mbeshtetje financiare, si student i vitit te pare ne Universitetin Politeknik te Tiranes, prej rezultateve ekselente. Sipas postimeve ne mediat tuaja sociale zyrtare, aplikimet kane perfunduar me 20 dhjetor, por mua ende nuk me eshte komunikuar me email apo nr.cel nese e kam perfutuar bursen apo jo. Ndaj ju shkruaj duke dashur te di nese konfirmimi do behet ne nje moment te dyte? Ju faleminderit!	30.12.2025	Përsëndetje, Aplikimet janë mbyllur në datë 20.12.2025, por ne jemi ende ne proces verifikimi. Ju do të njoftoheni me email sapo të mbyllet procesi. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
70	29.12.2025	Përsëndetje ! Aplikimin për bursën sa paga minimale e kam bërë. Dokumentat i kam dorëzuar para datës 20. Mbetem ende në pritje të përgjigjes suaj. Faleminderit !	30.12.2025	Përsëndetje, Aplikimet janë mbyllur në datë 20.12.2025, por ne jemi ende ne proces verifikimi. Ju do të njoftoheni me email sapo të mbyllet procesi. Faleminderit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
71	30.12.2025	Pershendetje!Uroj te jeni mire! Desha te pyes per sa i perket skemes se mbeshtetjes financiare per studentet ekselente(mesatare 10 dhe provimet e mature te gjitha mbi 9.5). Lidhur me te une kam derguar letrat ne zyren e akfal me date 17 nentor 2025,si dhe ne universitetin ku une studioj,Universiteti i Mjekesise Tirane kam dorezuar vertetimin e llogarise bankare si dhe i kam njoftuar qe jam perfutues per bursen akfal. Arsyeja pse po e shkruaj kete email eshte per arsye transparence per te kuptuar nese te dhenat e mia personale dhe bankare dhe kerkesa ime eshte pranuar qe te jem perfutues i burses akfal. Faleminderit paraprakisht per kohen dhe do e vleresoja shume nje pergjigje nga ana juaj. Me respekt dhe dashamiresi,	06.01.2026	Përsëndetje, Aplikimet janë mbyllur në datë 20.12.2025, por ne jemi ende ne proces verifikimi. Ju do të njoftoheni me email sapo të mbyllet procesi. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo